



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 32 prot.

Tiranë, më 08 . 01 /2021

URDHËR

Nr. 4 , datë 08 . 01 .2021

**“PËR
DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR NËNSHKRIMIN E DOKUMENTEVE
ADMINISTRATIVË QË DALIN NGA ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 147/d të Kushtetutës, dhe në zbatim të pikave 1, shkronja “c” dhe 5, të nenit 204, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe nenit 28-29 të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së nënshkrimit të dokumenteve administrative që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.
2. Ngarkohet Znj. Vilma Kola, Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, për nënshkrimin e dokumenteve që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që lidhen me:
 - a. Aktet e emërimit për nëpunësit të cilët rekrutohen sipas procedurave të shërbimit civil;
 - b. Akte për përcjellje njoftimi për procedurat e rekrutimit pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
 - c. Aktet për përcjellje dokumentacioni për kandidatet që kanë qënë pjesë e procedurave të rekrutimit, pjesë e shërbimit civil;
 - d. Akte për përcjelljen e formularëve të vetdeklarimit, për nëpunësit e emëruar, pranë Departamentit të Administratës Publike;
 - e. Vërtetim pune, vjetërsie, page dhe leje vjetore;
 - f. Nënshkrimin e librezave të punës për punonjësit/nëpunësit e institucionit.

3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin, publikimin dhe njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

